

BASHKIA KOLONJË
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Nr. prot

Data: 05.03.2021

Për: Operatorin ekonomik **HAMET ILJAZI PF**

Adresa: *Korçë Qëndër – Ersekë, Taç-Qëndër në të djathtë të Rruga Ersekë Leskovik, km i parë, ndërtesë private një katëshe, zona kadastrale 3558, numri i pasurisë 5/20.*

Procedura e prokurimit: **Kërkesë për Propozim, Shërbime.**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-86693-02-11-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Mirëmbajtje e automjeteve të Bashkisë Kolonjë viti 2021.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik HAMET ILJAZI PF

K67516029E

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera **4,799,000 (Katërmilioneshtatëqindënëntëdhjetëenëntëmijë) lekë pa tvsh.**

(me numra dhe fjalë)

2. Operatori ekonomik PINDERI shpk

J78317009O

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera **4,571,130 (Katërmilione pesëqindështatëdhjetëenjëmijëenjëqindëtridhjetë) lekë pa tvsh.**

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik PINDERI shpk

J78317009O

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

a. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 1, gërma b**, kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik **PINDERI shpk** është konstatuar se nuk ka plotësuar **shtojcën 1/1 Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur** ashtu sikurse kërkohet në pikën **6/a** ose **6/b** të formularit. Pra **OE PINDERI shpk** nuk ka deklaruar sipas **pikës 6** të **shtojcës 1/1** se: ka përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur pa u konsultuar, komunikuar dhe pa bërë marrëveshje me një operator tjetër **apo** është konsultuar me ndonjë operator tjetër për plotësimin e ofertës.

b. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.2.1** Kapaciteti ekonomik dhe financiar, kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Kopje e bilancit të vitit të fundit ushtrimor 2019, të paraqitur në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara prej tyre. (Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit).

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik **PINDERI shpk**, pasqyrat financiare të vitit **2019** nuk janë të konfirmuara nga Drejtoria e tatimeve përkatëse, pasi në të gjitha pasqyrat financiare që kanë vlerat e bilancit nuk ka asnjë nënshkrim dhe vule të drejtorisë se tatimeve përkatëse për konfirmim .

c.Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.2** Kapaciteti teknik, kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Operatori/et ekonomik duhet të disponojë minimumi një ambient pune (servis/oficinë) të përshtatshme për kryerjen e shërbimeve për të gjitha llojet e mjeteve sipas specifikimeve teknike objekt në funksion të realizimit të kontratës, të përshtatshëm për ushtrim aktiviteti sipas objektit të prokurimit “Mirëmbajtje e automjeteve të Bashkisë Kolonjë viti 2021”,i cili duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a.1 Ambienti (servisi/oficina) duhet të jetë brenda territorit të **Bashkisë Kolonjë**. Për këtë, operatori/et ekonomik ofertues, duhet të paraqes/in dokumentacion që vërteton pronësinë / huapërdorjen / qiramarrjen si më poshtë:

a.1.1 Dokumentacion që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; **ose**
- kontrata e shitblerjes; **ose**
- kontrata e dhurimit; **ose**
- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

a.1.2 Dokumentacion që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huapërdorje.

a.1.3 Dokumentacion që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik **PINDERI shpk**, është konstatuar se operatori ekonomik ka dorëzuar çertifikatë pronësie me vendodhje **Korçë, Zapë-Drenovë**, duke mos plotësuar kërkesën e vendosur nga autoriteti kontraktor,pasi Ambienti (servisi/oficina) nuk ndodhet brenda territorit të Bashkisë Kolonjë.

Gjithashtu operatori ekonomik **PINDERI shpk**, në përmbushje të kërkesës së sipërcituar të autoritetit kontraktor, nuk ka paraqitur asnjë nga format e tjera të kërkuara konkretisht:

- **Kontratë huapërdorje**

ose

- **Kontratë qiraje.**

Sa më lart, komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik **PINDERI shpk** në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe nuk konsiderohet i vlefshëm.

d.Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.3** Kapaciteti teknik,kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Operatori/et ekonomik në ambjentet e servisit ku ushtron aktivitetin duhet të ketë pajisjet e nevojshme për realizimin e kontratës, si më poshtë vijon:

- *Kompjuter për diagnostikimin e automjeteve,i pajisur me programe për automjetet sipas specifikimeve teknike të dst.*
- *komperator,set mikrometrash,kalibrash e pajisje të tjera ndihmëse*
- *pajisje për testimin e injektoreve.*
- *aparapër kontroll radiatorit uji.*
- *ura ngritëse për automjete (veturë/fuoristradë);*

- aparat per furnizimin me alkol dhe nxjerjen e ajrit të sistemit të frenimit;
- pajisje montim-çmontim gomash;
- aparat saldimi me oksigjen
- aparat saldimi me argon

Në lidhje me sa më sipër operatori/et ekonomik ofertues duhet të paraqesë **vetë deklaratë për pajisjet që disponon. Autoriteti Kontraktor, rezervon të drejtën të inspektojë në vend pajisjet e nevojshme e sipërpërmendura, me qëllim verifikimin e kërkesave të sipërcituara.**

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik **PINDERI shpk**, është konstatuar se operatori ekonomik nuk ka dorëzuar vetë deklaratë për pajisjet që disponon, duke mos plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktor .

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 46, pika 1, nenit 53, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall **të pavlefshme** ofertën e operatorit ekonomik **PINDERI shpk** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *operatorin ekonomik **HAMET ILJAZI PF me nius K67516029E dhe adresë: Korçë Qëndër – Ersekë, Taç-Qëndër në të djathtë të Rruga Ersekë Leskovik, km i parë, ndërtesë private një katëshe, zona kadastrale 3558, numri i pasurisë 5/20,*** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **4,799,000 (Katërmilioneshtatëqindënëntëdhjetëenëntëmijë) lekë pa tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë

Emri **Bashkisë Kolonjë**
Adresa **Sheshi “ Rilindja ”**
Tel/Fax **+355 812 2 2225 ; +355 812 2 3173**
E-mail **bashkia.kolonje@gmail.com**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi , por jo me vone se **5 (pesë) ditë** nga marrja e kërkesës me shkrim për lidhjen e kontratës.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në **datë :25.02.2021**

Ankesa: **Jo**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ERION ISAI